

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Analiza - Pse s'flitet për viktimat e krimeve të luftës?
ADRESA	https://www.syri.net/kosova/919602/pse-sflitet-per-viktimat-e-krimeve-te-luftes/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 06:35:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 06:21:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f53185aa25f8195288664c6a5f517d9dd2f5058bd181642c3ecc6105bd240da2
TEKSTI	03023479a7bc7618383afc1e55b2e4ce5ed861f5797aeaedc9d5593d0772e64c
PAMJA	9d7a9193f51926076d80beee267f468fea897524ee2ab457c29a9a17872a4781

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5fd858922d718ea1d10e788ab2c91bbf8ac9e063064e4990e594435efdb931ae
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c6e9ce599dcf050571ac11f5fe8a3879623b3af12e442f4fee76de6471dba328
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5fd858922d718ea1d10e788ab2c91bbf8ac9e063064e4990e594435efdb931ae>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



SONILA MEÇO
'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



ÇIM PEKA
Nga Çim Peka-Tradhtia që s'e panë tu ardhë



më të lexuarat

Kurti takohet me Hamzën, një ditë para seancës së Kuvendit

Në gjithë Kosovën sot protestohet kundër vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

12 netë protesta kundër dënimit të ish-udhëheqësve të UÇK-së

Prishtina edhe sonte në protestë, qytetarët mbledhen në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së

Ambasada amerikane: Mezi presim të punojmë me Qeverinë dhe Kuvendin e ri të Kosovës

Digjet sërish shtëpia e gazetarit Vudi Xhymshiti, ai ngre dyshime për lidhje me punën e tij, përmend figura të PDK dhe AAK

Ambasada amerikane: Mezi presim të punojmë me Qeverinë dhe Kuvendin e ri



Pse s'flitet për viktimat e krimeve të luftës?

08:21, 28/09/2026

Në stallë lopësh e bodrume, të lidhur me zinxhirë, të mbuluar me baltë dhe të rrethuar me jashtëqitje njerëzish e bagëtish, të varur kokëposhtë e të rrahur, me thonj të shkulur e gjymtyrë të thyera...

Qindra persona që konsideroheshin kundërshtarë të UÇK-së - mësues shkollash, bujq, pylltarë, punëtorë të thjeshtë dhe, në disa raste, gra dhe fëmijë - u tha të jenë ndaluar në mënyrë arbitrare e keqtrajtuar në këto forma gjatë luftës së fundit në Kosovë, më 1999.

Për këto krime lufte u dënuan më 16 shtator katër ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) nga Gjykata Speciale e Kosovës në Hagë.

Aktgjykimi ishte i shkallës së parë dhe ekipet mbrojtëse të Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit paralajmëruan se do ta apelojnë atë.

Prej ditës së shpalljes së tij, çdo natë, Sheshi Skënderbeu në Prishtinë grumbullon mijëra njerëz që brohorasin "Jo në emrin tim" dhe kundërshtojnë dënimin e atyre që i cilësojnë si "heronj" dhe "çlirimtarë".

Mes fjalimeve e këngëve, gati askush nuk flet për viktimat. Pse?

Agon Maliqi, bashkëpunëtor i lartë jorezident në Qendrën për Evropën të Këshillit Atlantik dhe njohës i zhvillimeve në Kosovë, thotë se kjo ndodh për shkak se verdikti ka sulmuar trashëgiminë e luftës çlirimtare dhe historinë e vendit.

Sipas tij, debati duhet të rifokusohet te "përgjegjësia individuale e atyre që i kanë bërë veprat, e jo duke ndërtuar një narracion të motiveve kriminale të liderit të UÇK-së".

"Duhet të pyesim sinqerisht: a janë të dënuarit ata që kanë qenë zbatuesit dhe urdhërdhënësit e veprave dhe se a vendos ky lloj verdikti drejtësi?", thotë Maliqi për Radion Evropa e Lirë.

Ai insiston se vendimi nuk ka sjellë drejtësi as për viktimat, as për të dënuarit, pasi përgjegjësia i është atribuar nivelit komandues pa u individualizuar për secilin rast.

Trupi Gjykses e lidhi përgjegjësinë e katër ish-krerëve të UÇK-së me një plan të përbashkët kriminal për të shënjestruar personat që konsideroheshin kundërshtarë të UÇK-së.

Katër të akuzuarit u tha se kontribuan në krijimin dhe zbatimin e këtij plani dhe se nuk ndërmorën hapa për ta ndaluar atë, ndërsa komandantët e zonave ishin

"zbatues të zellshëm" të këtij qëllimi kriminal.

"Megjithëse përgjegjësia e të akuzuarve është individuale dhe personale, ajo që ata bënë, nuk do të mund të ishte realizuar nga një person i vetëm. Atë e bënë bashkë, me vendosmëri dhe me ndihmën e të tjerëve", thuhet në përmbledhjen e aktgjykimit, ku flitet për qëllim të përbashkët kriminal.

Dhe pikërisht përmendja e një "ndërmarrjeje të përbashkët kriminale" nxiti reagim te qytetarët që ndiejnë se kështu njolloset lufta e bërë nga UÇK-ja.

Kush ishte UÇK-ja?

Disa qytetarë të intervistuar nga Radio Evropa e Lirë thonë se nuk besojnë se akuzat janë mbështetur në fakte dhe dëshmi të mjaftueshme, duke i cilësuar ato si spekulime dhe të papranueshme për popullin e Kosovës.

"Kush i ka konstatuar? Ku janë faktet? Ku janë dëshmitë? Ato janë veç spekulime", thotë Milaim Llugaxhiu nga Suhareka.

"Ato akuza janë qesharake, hajgare për popullin tonë", thotë Liridon Sheholli nga Podujeva.

"Nuk është e vërtetë, të gjithë e dimë", sipas Qemajl Hasanit nga Vushtrria.

"Nuk ka kurrfarë faktesh dhe si të tilla janë të papranueshme për ne dhe për popullin e Kosovës", thotë Bajram Beqiri, gjithashtu nga Vushtrria.

Aktgjykimi i plotë për këtë rast nuk është publikuar ende.

Por, përtej trashëgimisë së UÇK-së, njohësi i zhvillimeve në Kosovë, Agon Maliqi, thotë se viktimat nuk kanë marrë shumë vëmendje edhe për shkak të dy faktorëve të tjerë kyç: anonimiteti dhe dyshimet për profilin e tyre.

"Ekzistenca e dyshimeve se një pjesë e mirë e tyre mund të kenë qenë spiunë, apo bashkëpunëtorë dhe dëshmitarë të përpunuar nga Serbia, e bën shumë më të vështirë të mos i shohësh si viktimë, por thjesht si kolateral legjitim lufte", thotë Maliqi.

Në përmbledhjen e aktgjykimit, trupi gjykues konstatoi se të ndalurit akuzoheshin personalisht se ishin spiunë e tradhtarë dhe se bashkëpunonin me regjimin serb.

Por, "me përjashtime të kufizuara", gjyqtarët thanë se "nuk gjetën prova që viktimat kishin kryer veprimtari kriminale, kishin marrë pjesë aktive në luftime apo përbënin ndonjë shqetësim tjetër legjitim për sigurinë e UÇK-së".

Maliqi thotë se në atë kohë kishte njerëz që bashkëpunonin me autoritetet serbe, duke shtuar se ka një konsensus që "në rrethana lufte, së paku, ndalimi i personave të dyshuar është praktikë legjitime".

"Gjithsesi, dihet gjerësisht se njerëzit shpesh janë shënjestruar pa bazë dhe arbitrarisht nga fryma e mosbesimit, mospajtimet politike apo inatet personale", thotë ai.

Por, meqë emrat, fytyrat e historive të tyre - përveç rastit të Behajdin Allaqit - mbeten anonimë, ndaj tyre ka mosbesim.

Radio Evropa e Lirë kontaktoi familjen e Allaqit për koment pas aktgjykimit, por nuk mori përgjigje.

Maliqi thotë se është e kuptueshme që viktimat dhe dëshmitarët të kenë kërkuar anonimitet "për t'u mbrojtur nga gjykimi publik", por se kështu është krijuar perceptimi "që ata kanë faj dhe kanë diçka për të fshehur".

"Sidomos duke e ditur se përballë këtyre viktimave abstrakte në bankën e të akuzuarve nuk janë vetë kryesit e veprave, por figura me peshë historike, të cilët po gjykohen mbi logjikën e strukturës komanduese - gjë që automatikisht e zhvendos empatinë drejt tyre", thotë Maliqi.

Në mesin e viktimave u tha të ishin edhe persona që ndaloreshin vetëm se cilësoheshin "ushtarë të [Ibrahim] Rugovës", meqë mbështesnin Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK).

Pse kishte përplasje mes FARK-ut e LDK-së dhe UÇK-së?

Radio Evropa e Lirë kërkoi koment nga LDK-ja për përmendjen e tyre në aktgjykimin dënues për ish-krerët e UÇK-së, por s'mori përgjigje.

Publikisht, kjo parti doli po më 16 shtator me një komunikatë që kundërshtoi verdiktin e Speciales, duke thënë se "UÇK-ja mbetet pjesa më krenare e historisë moderne të popullit tonë" dhe se ajo vetëm "mbrojti prapën e shtëpisë".

Në këtë komunikatë, si në pothuajse të gjitha deklaratimet publike të bëra pas këtij

të Kosovës

Gërvalla: Çështja e Speciales është betejë ligjore, jo betejë deklaratash

Kuvendi pritet të miratojë deklaratën për aktgjykimin e Dhomave të Specializuara

veruiku, u triksuan krimet e kryera nga forcat serbe në Kosovë.

Krimet e luftës dhe kundër njerëzimit në Kosovë

Ngjashëm reagoi atë ditë edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili vendimin e përshkroi si "padrejtësi të papranueshme, ndëshkim të madh e të dëmshëm".

"Në këto momente të vështira, jemi pranë familjeve të ish-krerëve të UÇK-së dhe të gjithë bashkëluftëtarëve çlirimtarë", tha ai, pa përmendur viktimat në atë reagim, por duke i quajtur "konstatime të padrejta" përfundimet se ata kishin targetuar persona të konsideruar bashkëpunëtorë të regjimit serb.

Prej atëherë, ai u zotua se do të ofrojë gjithë mbështetjen e mundshme, përmes një strategjie shtetërore, për të ndihmuar ekipet mbrojtëse në apelimin e verdiktit.

Analisti politik, Ilir Deda, thotë për Radion Evropa e Lirë se mbështetja e apelimit të verdiktit "nuk duhet të shndërrohet në mohim të vuajtjes së viktimave".

"Respekti për viktimat nuk e dobëson mbrojtjen; përkundrazi, ia shton kredibilitetin", thotë ai, duke theksuar se përgjegjësia penale e individëve nuk mund të shndërrohet në faj kolektiv të UÇK-së apo shtetit të Kosovës.

Në Kosovë, shumica e organizatave që merren me drejtësi dhe çështje të të drejtave të njeriut, gjithashtu, e kundërshtuan verdiktin dhe shmangën përmendjen e viktimave.

Më 25 shtator, 11 prej tyre reagues ndaj Amnesty International, duke kundërshtuar mënyrën se si ajo e lidhi aktgjykimin me "mijëra viktima të luftës në Kosovë", pa përmendur krimet e kryera nga forcat serbe.

Amnesty International, në reagimin e saj, tha se dënimet "u japin shpresë mijëra viktimave të luftës në Kosovë".

Ata kërkuar që Amnesty të bëjë dallim mes viktimave dhe krimeve të trajtuara në rastin ndaj Thaçit dhe të tjerëve dhe viktimave të tjera të luftës - shumica viktima të forcave serbe.

Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë, në anën tjetër, u fokusua te viktimat e rastit të ish-krerëve të UÇK-së.

"Elitat politike në Kosovë e kanë rrënjësuar narrativën për luftën heroike të UÇK-së për liri kundër forcave serbe si pothuajse të vetmin interpretim të lejueshëm të luftës. Ky narrativ nuk mund t'i ndryshojë faktet e vërtetuara me aktgjykim", thuhet në reagim.

Megjithatë, Fondi pranoi se pakënaqësia në Kosovë vjen për shkak të "mungesës pothuajse të plotë" të ndjekjes penale të zyrtarëve serbë të asaj kohe në gjykatat në Serbi.

Ai insistoi se faktet e vërtetuara në aktgjykim nuk mund të relativizohen përmes etiketimit të viktimave si "bashkëpunëtorë".

Radio Evropa e Lirë kontaktoi këtë organizatë për të diskutuar pozitën e viktimave në debatin e krijuar pas aktgjykimit, por nuk mori përgjigje.

Sipas aktgjykimit, të paktën 385 persona ishin ndaluar në mënyrë të paligjshme ose arbitrare, 303 ishin torturuar, 49 ishin trajtuar në mënyrë mizore dhe 96 ishin vrarë./ [REL](#).

© SYRI.net

Lexo edhe:



Kuvendi pritet të miratojë deklaratën për aktgjykimin e Dhomave të Specializuara



Digjet sërish shtëpia e gazetarit Vudi Xhymshiti, ai ngre dyshime për lidhje me punën e tij, përmend figura të PDK dhe AAK



Prishtina edhe sonte në protestë, qytetarët mblidhen në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së

Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

TË NGJASHME



Kurti takohet me Hamzën, një ditë para seancës së Kuvendit



Pjesëtarët e FSK-së certifikohen pas trajnimit të avancuar për kërkim-shpëtim



'200 metrat' që liruan Gotovinën dhe mësimi për katërshen e UÇK-së



Nëntë të arrestuar për krime lufte në Zubin Potok lidhur me rastin e 'Grupit të Intelektualëve'



Stradner: Kremli mund ta ndihmojë Vuçiçin me energji



Kosova sonte përballë Austrisë, 'Dardanët' kërkojnë tri pikët në Vjenë

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIË ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.